



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

Studim: “Produktiviteti i prodhimit të ullishteve intensive për vaj me kultivarët e huaj Koroneiki, Arbequina në zonën e Vlorës”.

(Viti i parë i studimit: 2017)

1. Hyrje

Ulliri në vendin tonë, për rëndësinë e tij ushqimore, jo vetëm që është vlerësuar qysh në kohrat më të vjetra, por për të parët tanë, ka qenë e njohur mirë për kohën, edhe teknika e shtimit, e rritjes dhe ajo e nxjerrjes së vajit. Fakti që ne sot trashëgojmë ullin dhe ullishta në numër dhe sipërfaqe të mëdha, nga një e kaluar shumë e largët, tregon se në drejtim të përhapjes së ullirit, në vendin tonë dhe kultivimit të tij me kritere të drejta teknike për kohën, i është kushtuar gjithmonë një rëndësi dhe kujdes i veçantë.

Vitet e fundit mbjellja e ullishteve intensive ka gjetur shtrirje të gjerë në shumë vende të kultivimit dhe kryesisht në kultivarët Koroneiki dhe Arbequina.

Ullishtet intensive sot kanë rritje të sipërfaqes së mbjelljes të ullirit në rajonin e Mesdheut dhe më gjerë.

Ky model i mbjelljes së ullishteve është përpjekje e vazhdueshme e punës së fermerit për të rritur sasinë e prodhimit nëpërmjet futjes së shpejtë të ullirit në prodhim dhe rritjes së numrit të bimëve për sipërfaqe duke përshtatur paketa teknologjike për mirëmbajtjen, shkallën e lartë të mekanizimit, ujitjes, ushqimit të bimëve dhe mbrojtjes së tyre nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

2. Metodologjia e përdorur

Studimi u ngrit në parcelën e mbjellë në zonën e Novoselës dhe Mifolit (Vlorë), me ullishte intensive për vaj në kultivarët Koroneiki dhe Arbequina për të marrë një prodhim të hershëm me efektivitet të lartë ekonomik dhe me kosto të ulët.

Studimi u krye në periudhën Janar 2017 - Dhjetor 2017.

A. Parcela Novoselë

Kutivari Koroneiki: Sipërfaqja 1.2 dynym, Nr. bimëve 60, Distanca e mbjelljes 5m x 5m. Rrezja e vajit 17.2%.

Kutivari Arbequina: Sipërfaqja 1.4 dynym, Nr. bimëve 70, Distanca e mbjelljes 5m x 5 m. Rrezja e vajit 16.8%.

B. Parcela Mifol

1. Kutivari Koroneiki: Sipërfaqja 1.7 dynym, Nr. bimëve 70, Distanca e mbjelljes 5m x 4 m. Rrezja e vajit 17.6%.

2. Kutivari Arbequina: Siperfaqja 2 dynym, Nr. bimëve 80, Distanca e mbjelljes 5m x 4 m. Rrezja e vajit 17.2%.

3. Treguesit e marrë në studim

1. Prodhimi kg/rr
2. % e vajit (%)
3. Dokumentimi i shpenzimeve
4. Të ardhura



Figurë 1. Parcela Mifol



Figurë 2. Parcela Novosel



Figurë 3. Momente nga Vjelja

4. Rezultate dhe diskutime

Studimi u krye në dy parcela të veçanta në dy zona të ndara në Mifol dhe Novoselë.

Për të dy parcelat e marra si provë u monitorua për të dy kultivarët (Koroneiki dhe Arbequina), zhvillimi i bimës gjatë gjithë vitit (kurorë, degëza dhe fruti), u morën sipas afateve të gjitha shërbimet e kryera nga fermeri si shërbimet agroteknike, trajtimet krasitja, ujitja, plehrimet, u morën sipas kohës së pjekjes treguesit e prodhimit (kg/rr), si dhe rrezja e vajit e shprehur në (%).

Mosha e pemëve të ullirit të marrë në studim është 6 vjeçar. Në përgjithësi ullishtet e reja intensive në zonën fushore kanë shprehur nivele të ndryshme ekonomike megjithëse kanë qënë në kushte të njëjta të tokës, klimës dhe teknologjisë. Kultivarët Koroneiki dhe Arbequina kanë hyr nga Greqia dhe Spanja, megjithatë ato kanë shprehur indeks përshtatëshmërie të mirë.


Pemët kanë patur rritje të mirë vegjetative, i shprehur me densitetin e degëzave të diferencuara dhe gjatësinë mesatare të tyre. Rritja vegjetative është premisë e rëndësishme, sepse përbën bazën biologjike të frutifikimit të vitit pasardhës.

4.1 Prodhimi

Kultivarët kanë shprehur rezultate të mira të rendimentit kg/rr në dy fushat e studimit në Novosel dhe Mifol. Prodhimi është i shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë kurorën e pemës. Kalibri i frutave është konform standartit varietal në vendin e orgjinës përse i përket diametrit D dhe d, si dhe peshës mesatare të frutit. Pjekja e frutave ka nisur në fillim të muajit Nëntor deri në fillim të muajit Dhjetor.

Rendimenti mesatar për kultivarin Koroneiki është i ndryshëm ndaj dy parcelave të studimit. Në Novoselë rendimenti është 40 kg/rr ndërsa në Mifol është 34 kg/rr. Megjithëse pemët ishin në të njëjtat shërbime ndoshta ka ndikuar pjelloria e tokës e cila do të analizohet në vitin e fundit të studimit. Në mënyrë identike ka rezultuar dhe për kultivarin Arbequina sepse në Novoselë ka rezultuar 44/39, ose 5 kg më tepër.

Përse i përket prodhimit për sipërfaqen analizuar nëpërmjet një korrelacioni të rendimentit dhe prodhimit për sipërfaqe, egziston një lidhje e fortë ndaj të dy indekseve $r=93\%$, që do të thotë se me 93% , të rasteve prodhimi rritet në mënyrë të fortë sepse rritet rendimenti i cili është i varur prej tij.



Grafikë 1. Të dhënat e prodhimit për të dy parcelat

Në këtë analizë për vlerësimin e parametrave të lidhjes duken rezultate të vërtetuara nga fakti se vlera e t.faktike ishte e ndryshme dhe me e madhe se t.teorike. Pra, vertetohet hipoteza se në çdo rast të rritjes së rendimentit prodhimi për njësi të sipërfaqes shkon në rritje.

Analiza e variancës për të dhënat paraprake të këtij viti për të dy kultivarët, dhe në të dy fushat pasqyroj një rendiment mesatar 39.25 kg/rr. Por, rendimenti tregoi ndryshime të vertetuar ndërmjet vetë varietetit, ndërmjet varieteteve, dhe ndërmjet parcelave. Ndryshimet janë matur dhe vërtetuar për Prob > F 0.0092*, kundrejt F. faktike 7.80.

Rendimentin më të lartë e vërtetuar në kultivarin Arbequina kultivuar në Novoselë, si dhe Koroneiki në Novoselë.

Rendimentin më të ulët është provuar në kultivarin Koroneiki në Mifol me vlerën 34 kg dhe rendimenti më i lartë me kultivarin Arbequina në Novoselë përkatësisht 44 kg/rr.

Dy kultivarët kanë prodhimtari të ndryshme për njësi sipërfaqeje, dhe variacioni ka qënë rjedhojë e kultivarit, vendit të kultivimit dhe densitetit të mbjelljes. Dy kultivarët në të dy vendet kanë patur rendiment mesatar 29.2 për dyn.

Prodhimi më i madh ishte në varietetin Arbequina në Novoselë me 35.2 kv. Referuar sipërfaqeve të ullishteve me kultivarin Arbequina, frutat kanë patur 15.8% vaj dhe në parcelën e Novoselës është llogaritur 5.56 kv/vaj, ndërsa në parcelën me kultivarin Koroneiki me përqindje vaji në frut 17.0%, duke rezultuar 4.76 kv/vaj. Në këtë analizë për krahasimin e sasisë së vajit ndërmjet dy varieteteve rezultoi me rentabilitet kultivari Arbequina sepse në të njëjtin vend jep 0.8 kv/vaj më shumë

4.2 Shpenzime për parcelat

Tabelë 1. Shpenzimet e kryera për të dy parcelat e marra në provë

Nr.	Parcelat	Fuqi punëtore	Pune me mekanike	Baza materjale	Totali
1	Parcela Novoselë	117.300	14.100	14.500	145900
2	Parcela Mifol	112.460	10.600	14.500	137560

Tabelë 2. Numri i ditëve të punës harxhuar për sasinë e prodhimit të marrë

Numri i ditëve të punës sipas parcelave			
Nr.	Proçeset e punës	Novoselë	Mifol
1.	Punim me bel 9 m ² nën kurorë	10	6.2
2.	Krasitje	6	8.6
3.	Plehim 12 kg për rrënjë	1	0.8
4.	Ujitje 2 herë	7.2	5.2
5.	Vjelje prodhimi	54	54
	Totali	78.2	76.9

Sasia e ditëve të punës në dy parcelat e marra në studim është e ndryshme, kjo pasi dhe për vet numrin jo të njëjtë të bimëve që ato kanë.

Në parcelën në Novoselë fermeri ka harxhuar 78.2 ditë pune ndërsa në parcelën e Mifolit fermeri ka harxhuar 76.9 ditë pune. Kjo tregon se fermeri dhe pse ka një numër relativisht të vogël bimësh ulliri, vetëm një pjesë të kohës harxhon për këtë parcelë duke patur mundësi për t'u marrë dhe me punë të tjera gjatë vitit dhe për të rritur të ardhurat.

Tabelë 3. Sasia e vajit të marrë nga parcela Novoselë

Novoselë	Kultivari	Prodhimi	% e vajit	Sasia e vajit kg
1.	Koroneiki		17.2	
2.	Arbequina		16.8	317.6

Tabelë 4. Sasia e vajit të marrë nga parcela Mifol

Mifol	Kultivari	Prodhimi	% e vajit	Sasia e vajit
1.	Koroneiki	54.7	17.6	
2.	Arbequina		17.2	314.3

Tabelë 5. Të ardhurat

Parcelat	Sasia e vajit	Çmimi/kg	Totali i shitjes
Novoselë	317.6	800	254080
Mifol	314.3	800	251494

5. Konkluzione paraprake

Provat për sjelljen e dy kultivarëve kanë vërtetuar ndryshime të rendimentit, prodhimit dhe sasisë së vajit. Në këtë mënyrë këto janë produkt i shprehjes fenotipike në lidhje me ambientin, tipareve gjenetike të kultivarëve dhe produktit të tyre.

- Në përgjithësi duke gjykuar mbi rezultatet e rendimentit dhe prodhimit të dy kultivarëve në të njëjtën ambient nivel më të lartë performance ka paraqitur kultivari Arbequina.

- Këto rezultate janë paraprake sepse, analiza dhe konkluzionet përfundimtare për indekset biologjik, fenologjik dhe për rentabilitetin ekonomik do të kalkuloohen vitin e fundit të studimit.

Specialist:
Lumturi Xhelilaj